

UDHËZIM
Nr. 20, datë 12.6.2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 13, DATË 8.3.2018, “PËR ZHVILLIMIN
E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË, VITI SHKOLLOR 2017–2018”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 50, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 67, datë 10.2.2010, “Për krijimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 3.4.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 13, datë 8.3.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2017–2018”, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

1. Pika 2 e udhëzimit nr. 13, datë 8.3.2018, ndryshon si më poshtë:

“Nxënësit e pakicave kombëtare zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë në lëndën Gjuhë amtare. Provimi kombëtar i arsimit bazë në lëndën Gjuhë amtare, do të zhvillohet më 14 qershor 2018”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale/zyrat arsimore dhe institucionet arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla